



STANDARDI I PAGËS BAZË NË EVROPË

Paga e denjë në Evropën Qendrore,
Lindore dhe Juglindore

**Clean
Clothes
Campaign**



**FASHION
CHECKER**



Mars 2020

Clean Clothes Campaign (CCC) është një rrjet global organizatash pune dhe organizatash të të drejtave të njeriut, ku përfshihen edhe sindikatat. Qëllimi i tij është promovimi dhe mbështetja e përmirësimit të kushteve të punës në industrinë tekstile dhe të veshjeve. CCC-ja përdor studime me karakter veprimi për të ndërmarrë fushata mbi strategjitë e saj avokuese dhe lobuese në përpjekje për të sjellë në vëmendje të drejtat e njeriut në sektorin e industrisë tekstile. Në thelb të veprimtarisë së saj shtrihet e drejta e njeriut për pagë jetese, pasi ky është edhe thelbi i ankesave të punëtorëve.

Grupi i CCC-së që miratoi këtë raport është Fokus Grupi Evropian për Prodhimin, i cili përbëhet nga CCC dhe organizata të tjera në Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore në Shqipëri, Bullgari, Bosnjë-Hercegovinë, Kroaci, Republika Çeke, Gjeorgji, Hungari, Maqedoni të Veriut, Moldavi, Poloni, Rumani, Serbi, Sllovaki, Turqi dhe Ukrainë. Ky grup përbën aleancën që mbështet standardin ndërkufitar të pagës bazë në Evropë – PAGA MINIMALE NË EVROPË.

Kontakt: europe-east-south@cleanclothes.org

Autorët: Artemisa Ljarja, Dr. Bettina Musiolek - Entwicklungspolitischer Netzwerk Sachsen/Clean Clothes Campaign

Fotografite: Yevgenia Belorusets

Rishikues: Nivene Raafat

Dizajni dhe pamja grafike: Heather Knight



Bashkëfinancuar nga Bashkimi
Evropian

Kopertina dhe fotografia e raportit:
Yevgenia Belorusets

PASQYRA E LËNDËS

Përmbledhje - Standardi ndërkufitar me në qendër punëtorin për një pagë bazë jetese

- 1 Hyrje – pse fokusohemi te paga e jetesës?**
Prodhuar në Evropë – prodhuar ndershmërisht?
- 2 E drejta e njeriut për pagë jetese sipas të drejtës ndërkombëtare publike**
- 3 Cilat janë karakteristikat kryesore dhe të gjithëpranuara të pagës së jetesës?**
- 4 Si e specifikon CCC-ja pagën e jetesës?**
Paga e jetesës si pagë bazë neto
Çfarë janë saktësisht nevojat bazë?
Paga e jetesës si koncept familjar – qasje me ndjeshmëri gjinore
- 5 Pse pagat minimale ligjore nuk i mbrojnë punëtorët nga varfëria?**
Dallimi mes pagës së jetesës dhe pagës minimale ligjore
Politikat kufizuese për pagat të zbatuara pas krizës financiare gjatë viteve 2008-2009
Pagat minimale ligjore kundrejt pragut të varfërisë të BE-së
Pse pragu i varfërisë prej 60% të pagës mesatare është jo i mjaftueshëm për të matur varfërinë në punë në Evropë-Lindje/Jug?
- 6 Pse nevojitet një pagë ndërkufitare bazë?**
Cili është dallimi kryesor në vlerësimet e pagës ekzistuese të jetesës?
- 7 Metodologjia e llogaritjes së pagës së jetesës bazë ndërkufitare me në qendër punëtorin**
Çfarë duhet të ofrojë?
Pse është e thjeshtë?
Cilat parime të llogaritjes huazuar nga AFW-ja?
Ku devijuar nga metodologjia e AFW-së për llogaritjen e pagës minimale në Evropë?
Hapi 1: Numri i njësive konsumatore
Hapi 2: Kostot ushqimore të punëtorëve
Hapi 3: Kostot ushqimore si përqindje e shpenzimeve familjare
Hapi i fundit: Llogaritja e standardit të pagës së jetesës
- 8 Rekomandime**

PËRMBLEDHJE

Standardi ndërkufitar me në qendër punëtorin për një pagë bazë jetese

Blerësit duhet të paguajnë çmimin e plotë të artikullit të veshjes. Në të përfshihet edhe paga me të cilën punëtori ta përballojë jetesën.

Ajo çka tingëllon logjike është, në fakt, burim i një debati të madh politik mes aktorëve të sektorit global të prodhimit të veshjeve, duke përfshirë edhe ato sportive. Ndonëse e drejta për pagë jetese është një e drejtë e njeriut, pagat e punëtorëve janë shumë poshtë pagës së jetesës, kurse në Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore, ato janë ndjeshëm nën kufirin e varfërisë së BE-së.

E drejta e njeriut për pagë jetese është kodifikuar si nga institucionet e OKB-së, ashtu edhe nga organet evropiane. Objekti i këtyre rregullimeve janë shtetet. Që prej vitit 2011, Parimet Udhëzuese të OKB-së për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut ua kanë vendosur si detyrim edhe kompanive - jo vetëm shteteve - që të respektojnë të drejtat e njeriut.

Paga e jetesës është kryesore për gëzimin e të drejtave të njeriut dhe thelbësore për çdo zhvillim real. Përgjatë viteve të fundit, ku diskutimi mbi pagën e jetesës në industrinë e modës është ndihmuar kryesisht nga Clean Clothes Campaign,

veçoritë **kryesore të përkufizimit të pagës së jetesës** janë pranuar gjerësisht nga ekspertët dhe palët e interesit. Diskutimi aktual fokusohet më pak te përkufizimet e ndryshme dhe më shumë te mënyra e zbatimit të tij.

Aktualisht, ka shumë **nisma vullnetare** që synojnë rritjen e pagave në këtë sektor, por prapëseprapë punëtorët e industrisë së veshjeve në vendet në zhvillim (Jugu Global) dhe veçanërisht në "Vendet e botës lindore" marrin vetëm një copëz të vogël të pagës së jetesës. Për këtë, duhet të shkojmë përtej nismave vullnetare.

Tipar themelor i Pagës Minimale në Azi, si dhe i Pagës Minimale në Evropë është **ndjeshmëria gjinore**. Ne theksojmë dimensionin familjar të pagës së jetesës. Në shumicën e vendeve të prodhimit në Evropë, punëtorët e industrisë së veshjeve – zakonisht gra ose kryefamiljare – janë shpesh ato që sigurojnë jetesën e familjes. Bashkëshortët janë shpesh të papunë, angazhohen në veprimtari informale – ose emigrojnë në vendet e Evropës Perëndimore në kërkim të punës. Për shkak të kësaj varfërie në të ardhura, gratë punojnë jashtë orarit, bëjnë punë të dyta ose përpiqen të blejnë ushqime më të lira, gjë që i lë në varfëri absolute sa i përket kohës. Shumica e punëtorëve në industrinë e veshjeve në Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore marrin vetëm pagën minimale ligjore – pa llogaritur shpesh orët jashtë orarit.

Paga minimale e njohur me ligj në këto vende nuk parandalon rënien e punëtorëve në varfëri, por përkundrazi, përbën një garanci për varfërimin e tyre.

Sipas llogaritjeve të bëra në bazë të kufirit të varfërisë të BE-së (60% e rrogës mesatare mujore në vend), **pagat minimale janë, mesatarisht, të barabarta me dy të tretat e këtij pragu** (shih grafikun informues në fq-7).

Duke pasur parasysh ekuilibrin e pushtetit në mekanizmat kombëtarë të përcaktimit të pagës minimale dhe ekuilibrin e pushtetit mes qeverive kombëtare, Komisionit Evropian e Fondit Monetar Ndërkombëtar, nuk është çudi që qeveritë e pranojnë varfërinë e skajshme të përfituesve të pagës minimale. Pagat minimale janë standarde të negociuara politikisht, ku kostot e jetesës luajnë rol të vogël – në mos asnjë lloj roli. Përveç kësaj, pragu i varfërisë i BE-së prej 60% të pagës mesatare, është larg të qenit tregues i besueshëm i varfërisë në vende ku edhe pagat minimale janë paga varfërie.

Në përcaktimin e standardeve të duhura për pagat e jetesës, ne synojmë të shohim përtej kufijve kombëtarë.

Duke qenë një koncept që synon të ketë në qendër punëtorët, ai duhet të marrë në konsideratë modelin

global të biznesit të modës së prodhimit në masë. Ai synon të sfidojë kërcënimin e vazhdueshëm të zhvendosjes dhe të shmangies së konkurrencës për pagat. Me modelin global të biznesit të modës së prodhimit në masë, lind edhe nevoja për hartimin e një politike që lufton konkurrencën e zhvendosjes së industrive nga një vend/rajon në tjetrin për shkak të pagave – e prapëseprapë nuk i bën vendet e ndryshme të barabarta. Pikërisht ky ishte edhe qëllimi që i vumë vetes për pagën minimale në Evropë. Qëllimi ynë është që t'i vihet kufi "garës për pagën më të ulët" mes vendeve evropiane të prodhimit të veshjeve dhe brendapërbrenda secilit prej tyre.


Megjithatë, kjo nuk do të thotë që paga minimale në Evropë është llogaritja e vetme e mundshme.

Përkundrazi: standardet ndërkufitare dhe ato të pagave të jetesës kombëtare plotësojnë njëri-tjetrin. Ne i shmangemi kurthit të llogaritjes së pagës së përsosur, pasi një gjë e tillë nuk ekziston. Standardi i propozuar nga CCC-ja nuk ka për qëllim të përjashtojë hapësirat e politikave për devijim prej këtij standardi. Ai mund të përshtatet më tej nga sindikatat e vendeve të ndryshme në bazë të nevojave dhe konteksteve përkatëse.

Pagat minimale janë, mesatarisht, të barabarta me dy të tretat e kufirit të varfërisë të BE-së

PAGA MINIMALE

KUFIRI I VARFËRISË



Përmes qasjes sonë të përbashkët rajonale, synojmë intensifikimin e përpjekjeve urgjente për paga jetese dhe për mbështetjen e pushtetit negociues të sindikatave. Me krijimin e Pagës Minimale në Evropë, Fokus Grupi për Prodhimin Evropian i CCC-së dëshiron të lehtësojë marrjen e masave konkrete dhe të zbatueshme për arritjen e pagave më të larta për punëtorët e industrisë së veshjeve. Ne kemi për qëllim të arrijmë progresin për punëtorët e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore.

Qëllimi ynë është që të kemi një pagë jetese bazë ndërkufitare të llogaritur në mënyrë të tillë që të jetë e thjeshtë dhe e lehtë për t'u kuptuar. Burimet e kufizuara nuk krijojnë mundësi për studime të zgjeruara dhe të vazhdueshme. Për këtë arsye, mendojmë se metoda e përdorur nga Aleanca e Azisë për Pagën Minimale ka përcaktuar një pagë jetese sa u përket karakteristikave të sipërpërmendura: në bazë të ligjit të Engel, ajo përqendrohet tek ushqimi dhe më pak te të gjitha shpenzimet e tjera familjare.


Atëherë, si përcaktohet formula për Pagën Minimale Evropiane? Ashtu sikurse Paga Minimale Aziatike, ne llogarisim kostot e ushqimit, duke marrë për bazë një dietë prej 3000 kalorish në ditë. Paga Minimale Evropiane (PME) ndryshon nga simotra e saj aziatike sa i përket përqindjes së supozuar të shpenzimeve familjare për ushqimin. Janë përzgjedhur dy grupe vendesh, ku shpenzimet për ushqimin përbëjnë 30 dhe 40% në Evropë -Lindje/Jug. Kjo ndryshon nga Paga Minimale Aziatike, ku raporti mes shpenzimeve ushqimore me ato joushqimore tashmë është 1:1.25 (pjesa që zë ushqimi = 45%).



Kështu, për vitin 2018 që është marrë si referencë, llogaritëm Pagën Minimale Evropiane prej 1 980 PPP USD për Serbinë, Bosnjë-Hercegovinën, Gjeorgjinë, Maqedoninë e Veriut, Shqipërinë, Ukrainën dhe Moldavinë dhe 2 640 PPP USD për Sllovakinë, Hungarinë, Poloninë, Turqinë, Kroacinë, Republikën Çeke, Bullgarinë dhe Rumaninë.

INFOGRAFIKA:

Llogaritja e pagës së jetesës bazë ndërkufitare për Evropën sipas monedhës vendase, 2018²



1 Hyrje: Pse fokusohemi te paga e jetesës?

Pagesa e varfërisë përbën një realitet të turpshëm, nëse shohim fitimet e nxjerra nga markat dhe shitësit me pakicë në zinxhirin e furnizimit të veshjeve.

Ata përfitojnë nga kontrolli i dyfishtë që kanë mbi tregjet ndërkombëtare të konsumatorëve dhe mbi zonat e prodhimit me kosto të ulët në Jugun Global dhe në 'Lindjen Globale'. Në tregun e prodhimit, markat dhe shitësit me pakicë kanë krijuar tradicionalisht një lloj presioni konkurrues për kontrata me furnitorëve të tyre, duke çuar në një garë për uljen e kostove të prodhimit.

E drejta për një pagë jetese është e rëndësishme për fuqizimin e grave jo vetëm në vendet e tyre të punës, por edhe për anëtarët ekonomikisht aktivë të shoqërive të tyre. Punësimi me një aspekt gjinor përbën faktor për nivelet e pagave, pasi gratë janë ato që dominojnë repartet e fabrikave të veshjeve. Ato zakonisht paguhen më pak se burrat dhe u jepen më pak mundësi për t'u promovuar në pozicione pune që paguhen më shumë. Kontratat e pasigurta të punësimit çojnë në një pasiguri të vazhdueshme për të ardhurat.

Kur gratë punësohen, ato shpesh përballen me një sistem të sigurimeve shoqërore joekzistente ose jofunksionale, ose konstatojnë se nuk u janë paguar kontributet financiare në sistemin e sigurimeve shoqërore. Pagat që u jepen aktualisht punëtorëve të industrisë së veshjeve janë të pamjaftueshme; në vend që t'u ofrojnë pasurim, ato i mbajnë punëtorët në varfëri, në borxhe dhe në një status më të ulët tradicional në shoqëri dhe në tregun e punës. Këto kushte duhet të ishin ndryshuar me kohë.

Disa shitës me pakicë dhe disa marka e pranojnë parimisht të drejtën për një pagë jetese në kodet e tyre vullnetare; megjithatë, në praktikë ata shpesh, thjesht monitorojnë respektimin nga ana e furnitorëve të pagës minimale parashikuar me ligj në çdo vend ku operojnë. Pothuajse asnjë prej tyre nuk garanton pagë jetese në praktikë.³ Ndërkohë, qeveritë në rajonet prodhuese, si në Evropën Qendrore-Lindore-Juglindore, i mbajnë **pagat minimale sa më të ulëta që të jetë e mundur**, mesatarisht sa një e katërta e nivelit minimal të jetesës (shih tabelën në faqen 11), duke i krahasuar pagat vazhdimisht me vendet konkurruese dhe duke pasur parasysh rrezikun se markat mund të vendosin që t'i porosisin produktet në vende të tjera. Kërcënimi i zhvendosjes së markave përbën një pengesë thelbësore në negocimin e pagave, si dhe një pengesë shumë të madhe për një krah pune të organizuar.

3. Shih CCC (2019): Tailored Wages, <https://archive.cleanclothes.org/resources/publications/tailored-wages-2019-the-state-of-pay-in-the-global-garment-industry>



Në teori, sindikatat duhet të jenë në gjendje të negociojnë paga më të larta sesa minimumi apo dyshemeja e parashikuar me ligj. Në praktikë, në shumicën e vendeve nuk ekziston kjo pagë minimale.

Ky dokument **sintetizon dhe konkludon mbi diskutimet** e zhvilluara në takime të shumta që prej vitit 2014 të Fokus Grupit të Prodhimit Evropian (Grupi i Evropës-Lindje/Jug) të CCC-s. Qëllimi ynë ka qenë gjetja e një metodologjie për përcaktimin e standardit bazë të pagës minimale të jetesës për vendet evropiane të prodhimit të veshjeve. Pas shumë diskutimeve, grupi doli me vendime për aspekte shumë të rëndësishme, argumentimi për të cilat jepet më poshtë. Gjatë gjithë këtyre viteve, kemi qenë në kontakt të ngushtë me Aleancën Aziatike për Pagën Minimale për të mësuar nga përvoja dhe njohuritë e tyre.

PRODHUAR NË EVROPË - PRODHUAR NDERSHMËRISHT?

Duket se ekziston gjerësisht perceptimi se kushtet e punës dhe pagat në prodhimin evropian të modës janë më të mira sesa në Azi. Clean Clothes Campaign ka ngritur pikëpyetje mbi këtë nocion në raportin e saj të vitit 2014 *Stitched up*, ku konstatoi se hendeku mes pagës minimale dhe pagës reale të punëtorëve dhe një page jetese minimale të llogaritur është e prirur të jetë më e madhe në Evropë sesa në Azi. Në Evropën-Lindje/Jug konstatojmë një nivel krahasimisht të ulët sindikatash në përgjithësi dhe veçanërisht në industrinë e veshjeve.



4. *Stitched Up – Pagat e varfërisë në industrinë tekstile në Evropën Lindore dhe Turqi*, fq. 34/35: <https://cleanclothes.org/file-repository/resources-publications-stitched-up-1/view> - vizituar për herë të fundit më 15/2/2020. Shihni edhe profilet e vendeve të CCC-s nga rajoni: <https://cleanclothes.org/campaigns/living-wages-in-europe> - vizituar për herë të fundit më 15/2/2020.

5. Termi 'Evropë-Lindje/Jug' përdoret për të përshkruar rajonin e Evropës Qendrore, Qendrore-Lindore dhe Juglindore.

6. Kurz Vandaele / ETUI (2019): Premiset e zymta: hartëzimi i anëtarësisë së sindikatave në Evropë që në vitin 2000. <https://www.etui.org/Publications2/Books/Bleak-prospects-mapping-trade-union-membership-in-Europe-since-2000>

2

E drejta e njeriut për pagë të denjë sipas të drejtës ndërkombëtare publike

E drejta e njeriut për pagë të denjë është një e drejtë e vendosur nga **Deklarata Universale e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut**:

“Gjithkush që punon ka të drejtën për një shpërblim të drejtë dhe të favorshëm, në mënyrë që t’i sigurojë atij dhe familjes së vet një ekzistencë në lartësinë e dinjitetit njerëzor”

(Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, neni 23, pika 3). “Ofrimi i pagës së mjaftueshme të jetesës” është përmendur që në hyrjen e Kushtetutës së ILO-s (1919).⁷ Ky nocion rikonfirmohet më vonë nga përkufizimet e ILO-s për Punën e Denjë.

Në kontekstin evropian, Karta Evropiane Sociale e Këshillit të Evropës (ESC 1965) dhe versioni i saj i rishikuar i vitit 1999 e kodifikojnë të drejtën për pagën e jetesës në nenin 4, nr. 1: “të njohin të drejtën e punëtorëve për një shpërblim të tillë që u jep atyre dhe familjeve të tyre një standard të denjë jetese”.⁸ ESC njihet në të gjithë Evropën dhe jo vetëm në shtetet anëtare të BE-së. Në vitin 2017, Bashkimi Evropian ngriti Shtyllën Evropiane të të Drejtave Sociale (EPSR),⁹ e cila i referohet “të drejtës për paga të drejta që ofrojnë një standard të denjë jetese” (EPSR).

Paguani punëtorët me

PAGË JETESE



Ata duhet të jenë në gjendje të përballojnë:



ushqimin



qeranë



kujdesin
shëndetësor



arsimimin



rrobat



transportin



kursimet



Paga e jetesës është një e drejtë njerëzore, për të GJITHË njerëzit, në të GJITHË botën

7. Raporti i paraqitur në Konferencën e Paqes nga Komisioni për Legjislacionin Ndërkombëtar të Punës (1920a). Gjetet në: http://www.ilo.org/public/libdoc/ilo/1920/20B09_3_engl.pdf

8. Karta Evropiane Sociale, gjendet në: <https://rm.coe.int/168006b642>

9. Shtylla Evropiane e të Drejtave Sociale, fq. 15. https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/social-summit-european-pillar-social-rights-booklet_en.pdf

3 Cilat janë karakteristikat kryesore dhe të gjithëpranuara të pagës së jetesës?

Diskutimet e shumta për bazën normative të së drejtës për pagë jetese çuan në nevojën për rishikimin e karakteristikave të saj kryesore. Disa prej këtyre karakteristikave janë ato që pranohen gjerësisht nga shumica e grupeve të interesit dhe ekspertëve:

- a. Si një e Drejtë universale e Njeriut, ajo vlen për **të gjithë** punëtorët, pavarësisht statusit të tyre në vendin e punës, produktivitetit apo situatës së tyre personale (p.sh. gjendja civile). Është paga më e ulët e paguar dhe asnjë punëtor nuk duhet të paguhet më pak sesa paga e përcaktuar e jetesës.
- b. Ajo duhet të jetë gjithmonë e mjaftueshme për plotësimin e **nevojave bazë** të punëtorëve, duke përfshirë ujin e pijshëm të sigurt, shërbimet sanitare, transportin publik, shërbimet shëndetësore dhe arsimore.¹⁰
- c. dhe ato të **familjeve** të tyre,
- d. si dhe **të ofrojë të ardhura specifike sipas nevojave të** vetë familjes (zakonisht 10% më shumë sesa kostot e të gjitha nevojave bazë).
- e. ajo duhet të fitohet **gjatë orarit normal** të punës, d.m.th. pa llogaritur orët e punës jashtë orarit.

Paga e jetesës është një kategori që përfshin vetëm kostot e jetesës. Kapaciteti prodhues apo ekonomik i punëdhënësit **nuk** merret parasysh.



10. Organizata Ndërkombëtare e Punës (1977) Punësimi, Rritja dhe Nevojat Bazë: problem botëror: Strategjia ndërkombëtare e "Nevojave Bazë" kundër varfërisë kronike, përgatitur nga Zyra Ndërkombëtare e Punës, ILO, dhe vendimet e Konferencës Botërore të Punësimi të vitit 1976, Këshillit të Zhvillimit jashtë Shtetit dhe Zyrës Ndërkombëtare të Punës, Praeger, fq. 32

4 Si e specifikon CCC-ja pagën e jetesës?

Aktorët dhe faktorët e ndryshëm të interesit nuk kanë dallime të mëdha kur vjen fjala te përkufizimi i pagës së jetesës dhe, rrjedhimisht, tek llogaritja e saj.

Në këtë dokument, duam të shpjegojmë se si i specifikon CCC-ja karakteristikat e sipërpërmendura të pranura gjerësisht.

PAGA E JETESËS SI PAGË BAZË NETO

Paga e jetesës është **paga bazë neto për një javë të zakonshme pune** (kohëzgjatja e javës së punës sipas legjislacionit të brendshëm), pa llogaritur orët jashtë orarit, shpërblimet, bonuset apo taksat. Me fjalë të tjera, është paga që punëtorët marrin me para të thata në dorë në fund të një muaji të zakonshëm pune. Ndonëse punëtorët më përpara përfitonin nga një gamë shërbimesh të subvencionuara në lidhje me strehimin publik, kujdesin për fëmijët, ngrohjen, transportin e kështu me radhë, procesi i ri-dekomodifikimit apo privatizimi i shërbimeve që dikur kanë qenë publike - e kanë zgjeruar shportën e mallrave dhe shërbimeve për të cilat ata tashmë duhet të paguajnë nga të ardhurat e tyre.¹¹ Paga që ata çojnë në shtëpi duhet të mbulojë edhe shpenzimet që më parë financoheshin përmes kontributeve sociale dhe tatimit mbi të ardhurat.

Paguhet me para të thata (cash), jo në natyrë. Marrja e një pjese të këtyre të ardhurave në natyrë, në formë kuponësh ose në forma të tjera përfitimesh do t'i bënte punëtorët të varur nga punëdhënësi dhe nga pozicionet e tyre të punës, duke kufizuar kështu ndjeshëm lirinë e tyre ekonomike dhe duke prekur në të njëjtën kohë të drejtën e tyre për vetëvendosje ose vendimmarrje të lirë.

11. Eurofund (2018), *Concept and practice of a living wage*, Publications Office of the European Union, Luxembourg, available at: https://www.eurofound.europa.eu/sites/default/files/ef_publication/field_ef_document/ef18064en.pdf

ÇFARË JANË SAKTËSISHT NEVOJAT BAZË?

Nevojat elementare për të cilat bën sondazh CCC-ja sa u përket punëtorëve të veshjeve në Evropë janë ushqimi (dieta prej 3 000 kalorish në ditë), veshja, transporti (biletat e transportit publik), strehimi (qiraja e shtëpisë ose këstet e kredisë së shtëpisë, kostot normale të mbajtjes së familjes), shërbimet utilitare dhe komunikimi (energji elektrike, ngrohja, uji, mbledhja e mbeturinave, telefoni, interneti), arsimi, argëtimi dhe kultura, kostot normale të shëndetit dhe higjienës, si dhe pushimet (udhëtim njëjavor brenda vendit për të gjithë anëtarët e familjes).

PAGA E JETESËS SI KONCEPT FAMILJAR - QASJA ME NDJESHMËRI GJINORE

Normat ndërkombëtare publike më lart e përkufizojnë qartë pagën e jetesës si pagë familjare. Në parim, paga e jetesës duhet t'u paguhet punëtorëve pavarësisht situatës së tyre personale. Nëse paga e jetesës ndahet në pagë për persona të pamartuar dhe në paga për familjarë, konkurrenca dhe presioni i kostove do të bënte që punëtorët dhe familjet e tyre të preken nga diskriminimi në punësim, ndërsa punëtorët e pamartuar të privoheshin nga mundësia për të krijuar familje. Studimet në terren kanë treguar se punëtorët femra diskriminohen nëse mbesin shtatzënë ose këshillohen të mos mendojnë për fëmijë për sa kohë janë të punësuar në fabrikë. Nëse llogarisim pagën e jetesës si pagë familjare, ku me familje kuptojmë rrethin e kujdesit familjar që nuk kufizohet vetëm te familja si bërthamë. Përfshin edhe pritshmëritë shoqërore dhe detyrimet që u ngarkohen grave dhe mban parasysh realitetet si nevojën për të mbështetur familjen e madhe dhe punën e papaguar në formën e përkujdesjes për të moshuarit dhe fëmijët. Ndërrthurrur me prirjen për emigrim që kanë të rinjtë dhe veçanërisht më të shkolluarit, deficit i kujdesit do të thellohet padyshim dhe do të shtrojë sfida të mëdha për ato shoqëri.¹²

Paga e jetesës është thelbësore për gëzimin e të drejtave të njeriut. Ajo përbën një mjet të rëndësishëm jo vetëm për përmirësimin e situatës së punës së punëtorëve gra, por edhe për të krijuar një mjedis ku ato mund të shfrytëzojnë kapacitetet e tyre të plota. Nëse koncepti i pagës së jetesës nuk përfshin një qasje me ndjeshmëri gjinore, mundet që mungesa e të ardhurave familjare të vazhdojë të çojë në një shpërndarje të të ardhurave brenda familjeve që diskriminon gratë dhe vajzat dhe që, p.sh., i lë ato me më pak ushqime të shëndetshme ose u mohon atyre aksesin në shkollë ose në shërbime mjekësore. Studimet në terren kanë konfirmuar se ndër punëtorët e industrisë së veshjeve apo familje të tjera me të ardhura të ulëta, gratë dhe vajzat shpesh hanë ushqime me më pak vlera ushqimore sesa burrat dhe djemtë dhe marrin më pak para për shkollim të shtrenjtë apo shërbime mjekësore.

Tjetër arsye për të theksuar dimensionin familjar të pagës së jetesës është fakti se në shumicën e vendeve prodhuese në Evropë, punëtorët e prodhimit të veshjeve dhe zakonisht gratë janë ato që **sigurojnë bukën e gojës**, ose nënat kryefamiljare. Shumë shpesh bashkëshortët¹³ janë të papunë ose punojnë në të zezë ose emigrojnë në vendet e Evropës perëndimore në kërkim të punës. Këto të ardhura varfërie i shtojnë gratë të bëjnë më shumë orë pune shtesë, të bëjnë punë të dyta ose të kërkojnë ushqime të lira, të cilat nuk u lënë absolutisht kohë për gjëra të tjera, pra në varfëri sa i përket kohës.¹⁴

Për më tepër, gratë janë më të prirura se meshkujt që të bëjnë punë informale. Ngjitur me punëtorët me kontratë, mund të punojnë gra pa pagë të caktuar, paguhen për artikull dhe pa orar fiks, fitojnë pak (jo një pagë jetese dhe shpesh nën standardin e pagës minimale ligjore), nuk paguhen në kohë, nuk kanë kontratë pune, nuk kanë përfitime shoqërore, edhe nuk janë prioritet për shumicën e strukturave shtetërore, politike dhe të punës.

12. Sidomos problematik është emigrimi i një numri të lartë punonjësish të kujdesit (p.sh. infermierë dhe mjekë) drejt Gjermanisë dhe vendeve të tjera të Evropës perëndimore, për shkak të politikave për tërheqjen e këtyre profesioneve.

13. Shih për shembull, Profili i Shtetit të Rumanisë në vitin 2019: <https://cleanclothes.org/livingwage/europe/country-profiles/romania/view>.

14. Luginbühl, C. (2019): A do të përfitojnë punëtorët nga paga e jetesës? Qasje me ndjeshmëri ligjore ndaj pragut të pagës së jetesës në zinxhirët e furnizimit global të veshjeve dhe këpucëve, gjendet në: https://cleanclothes.org/file-repository/ccc_dec2019_luginbuhl_lw_gender.pdf/view. Varfëria kohore është koncept i zhvilluar me varfërinë e të ardhurave nga Clair Vickery në 1977 ('Të Varfërit kohorë: Qasje e re ndaj varfërisë', Journal of Human Resources, 12, 1, 27-48, Win 77). Nevoja për të shkurtuar vazhdimisht kostot kërkon kohë: pazari për ushqimin më të lirë, p.sh. kërkon më shumë kohë. Përveçse bëjnë një ose disa pune dhe ofrojnë shërbime të papaguara kujdesi, gratë me të ardhura të ulëta janë të detyruara të harxhojnë kohë joproporcionale në punët e shtëpisë.

5 Pse pagat minimale ligjore nuk i mbrojnë punëtorët nga varfëria?

Në këtë pjesë do të argumentojmë se politikat dhe nivelet e pagës minimale, si dhe mënyrat e matjes së varfërisë në Evropë janë të pasuksesshme për të lehtësuar punëtorët me të ardhura të ulëta.

Në vend të pagës së jetesës, standardi aktual për punëtorët e prodhimit të veshjeve është paga minimale ligjore. Shumica e këtyre punëtorëve në mbarë globin marrin pagën minimale ligjore gjatë orarit të rregullt të punës, shpesh edhe këtë vetëm me orë shtesë.¹⁵

DALLIMI MES PAGËS SË JETESËS DHE PAGËS MINIMALE LIGJORE

Këto dy koncepte dallohen nga një parim thelbësor. Pagën e jetesës e perceptojmë si parim të së drejtës së njeriut bazuar posaçërisht në koston e jetesës. Nga ana tjetër, pagat minimale ligjore janë politika bazuar në treg dhe, si të tilla, përcaktohen mbi bazën e avantazhit krahasues ekonomik të një vendi. Pavarësisht faktit se paga minimale dhe paga e jetesës janë të ngjashme në kuptimin se synojnë të sigurojnë të ardhura të mjaftueshme për të kompensuar ata që paguhen pak, pagat minimale janë të ligjshme dhe të detyrueshme, ndërsa paga e jetesës është aktualisht e parregulluar në shumicën e rasteve.

Paga minimale dhe paga e jetesës janë të ngjashme në kuptimin që të dyja japin shpërblim për punën e kryer; megjithatë, mbulimi i tyre ndryshon. Paga minimale është pagë individuale, ndërsa CCC-ja thekson konceptin e dimensionit familjar. Nivelet e pagës minimale devijojnë ndjeshëm nga perspektiva e nevojave kundrejt koston së jetesës, për shkak se duhet të pasqyrojnë "prodhueshmërinë afatmesme të sektorit industrial plus normën e synuar të inflacionit të bankës qendrore".¹⁶

15. Si, për shembull, në Bullgari: https://cleanclothes.org/file-repository/2019_ccc-countryprofile-bulgaria_eng.pdf/view; https://cleanclothes.org/file-repository/2019_ccc-countryprofile-bulgaria_eng.pdf/view.

16. Herr, H. dhe Kazantziska, M. (2011) Parimet e Politikës së Pagës Minimale – Ekonomiksi, Institucionet dhe Rekomandime; dokumente pune të Global Labour University; nr. 11

TABELA:

Dallimi mes pagës minimale dhe pagës së jetesës

	Paga minimale	Paga e jetesës
Kush paguan	Punëmarrësi	Punëmarrësi
Objektivi	Përfituesit e pagës	Përfituesit e pagës
Mbulimi	Individual	Familjar
Ligjërshet e zbatuar	Po	Jo*
Parimi themelor	Në praktikë: avantazhi konkurrues	Të drejtat e njeriut – kostoja e jetesës
Metoda	Me bazë tregu	Me bazë nevojash
Mekanizmi	Institucione trepalëshe/ qeveria	Partnerët socialë/ vetëvlerësimi

* Pavarësisht dispozitave kushtetuese për pagën e jetesës, në Kroaci, për shembull.

Në fund, ndryshon edhe procesi me të cilin përcaktohen nivelet sasiore të këtyre dy parimeve. Në shumicën e vendeve të Evropës qendrore, lindore dhe juglindore, mekanizmi për përcaktimin e pagave minimale supozohet të negociohet nga tri palë (ministria e punës, shoqata e punëdhënësve dhe sindikatat) dhe të përshtatet çdo vit. Në shumë vende, organet trepalëshe nuk marrin vendime; nëse nuk gjejnë konsensus, vendos qeveria. Në vitin 2018, për shembull, në Bullgari, Kroaci, Çeki, Poloni e Sllovaki, partnerët socialë nuk ranë dakord për nivelin e pagës minimale në fund të konsultimeve dhe negociatave në organet kombëtare tripalëshe. Pastaj, qeveria e vendosi nivelin në mënyrë të njëanshme.¹⁷

POLITIKAT KUFIZUESE PËR PAGAT TË ZBATUARA PAS KRIZËS FINANCIARE GJATË VITEVE 2008-2009

Për më tepër, periudha e recesionit që pasoi krizën financiare të vitit 2008 u pasqyrua edhe në nivelet e pagës minimale. Në shumicën e vendeve të rajonit u miratuan kufizime buxhetore rreth rritjes së pagës në sektorin publik.¹⁸ Sipas politikës kushtetuese të FMN-së, Bullgaria, Hungaria, Bosnje-Hercegovina, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Serbia dhe Rumania “u këshilluan” që të ngrijnë pagat e sektorit publik dhe pensionet në terma nominalë në vitet 2009 dhe 2010, të cilat ndërmorën kështu shkurtime buxhetore të forta dhe stopuan pagat. Përveç kësaj, shumë qeveri janë përpjekur të lidhin kufizimet e pagave në sektorin publik me kontrollet mbi progresionin e pagave në sektorin privat, si në Ukrainë.¹⁹

Komisioni Evropian dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) tani po lëvdojnë presidentin, parlamentin dhe qeverinë ukrainase për “aktivitetin e shpejtë legjislativ”.²⁰ Fokusi i tyre kryesor është disiplina fiskale ku të drejtat e punës dhe të njeriut nuk luajnë rol. Në Raportin e Zbatimit të Asocimit për Ukrainën publikuar më 12 dhjetor 2019, Komisioni Evropian nxiti “reformat” me masa shtrënguese, si p.sh. reduktimin e transfertave sociale dhe dobësimin e ligjit të punës dhe institucioneve për mbrojtjen e punëtorëve, p.sh. inspektimet e punës. Teksa KE-ja kritikon “dobësimin e disiplinës fiskale për shkak të rritjes së pagave dhe pensione”, iu desh të pranonte se pagat në Ukrainë janë ndër më të ulëtat në Evropë²¹ Në vitet 2016-2019, pensionet mujore minimale u rritën nga 43²² Euro në 61 Euro, që është vlera që shumica e grave përfitojnë si pension.

17. Eurofound (2019) Pagat minimale në 2019: Raport vjetor, Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian, Luksemburg, fq. -15)

18. ESchmidt, V. dhe Vaughan-Whitehead, D. (eds.) (2011) Ndikimi i Krizës të Pagat në Evropën Juglindore; Zyra Ndërkombëtare e Punës (ILO), Ekipi Mbështetës Teknik për Punë të Denjë i ILO-s, si edhe Zyra për Evropën Qendrore dhe Lindore. ILO, fq. 16

19. CCC: Profili i Ukrainës; <https://cleanclothes.org/livingwage/europe/country-profiles/ukraine>

20. European Commission: Association Implementation Report on Ukraine, 12/12/2019. https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/swd_2019_433_f1_joint_staff_working_paper_en_v4_p1_1056243.pdf – vizituar së fundmi 15/2/2020


21. Po aty, 11-12.

22. CCC, Profili i Ukrainës – fq. 10: <https://cleanclothes.org/livingwage/europe/country-profiles/ukraine>

Ndër masat shtesë ²³ për të përballuar pasojat e krizës dhe për të shmangur recesionin e thellë ishte edhe taksa e sheshtë, që ka përkeqësuar pozitën relative të punëtorëve me paga të ulëta, si edhe ofrimi i zbritjeve për investitorët. ²⁴ ²⁵ Qoftë me ngrirje apo kufizime të pikut që mund të arrijë paga minimale, objektivi ishte të prioritzohej punësimi përmes uljes së kostove të punës, paçka se rëndohej barra mbi punëtorët dhe rezultonte në zgjerim të varfërisë në punë.

Ka një disbalancë të theksuar të pushtetit dhe influencës ndërmjet qeverisë, shoqatave të punëdhënësve dhe sindikatave, por edhe kundrejt aktorëve të tjerë lobues si Dhoma Amerikane e Tregtisë, Banka Qendrore Evropiane, FMN-ja dhe Bashkimi Evropian. Axhenda e politikave të tyre ekonomike peshon shumë në përcaktimin e pagave minimale ligjore.

Infografika tregon se Pagat Minimale në Evropë janë mesatarisht katër herë më pak se paga minimale e një vendi. Sa më e madhe diferenca, aq më e ulët është paga minimale ligjore në vendin përkatës.



23. Si për shembull, në Bullgari: https://cleanclothes.org/file-repository/2019_ccc-countryprofile-bulgaria_eng.pdf/view


24. Schmidt, V. dhe Vaughan-Whitehead, D. (eds.) (2011) Ndikimi i Krizës te Pagat në Evropën juglindore; Zyra Ndërkombëtare e Punës (ILO), Ekipi Mbështetës Teknik për Punë të Denjë i ILO-s, si edhe Zyra për Evropën Qendrore dhe Lindore. ILO, fq. 17

25. Shih Kapitullin 4 të Luginbühl, C. dhe Musiolek, B. (2016). Fushata e Rrobave të Pastra: Puna me kacidhe. Realitetet e punës në fabrikat e këpucëve të periferive të Evropës në Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë, Maqedoni, Poloni, Rumania dhe Sllovakia., Entwicklungspolitisches Netzwerk Sachsen e.V. & Public Eye; <https://cleanclothes.org/resources/recommended-reading/labour-on-a-shoestring>

* Pagën minimale ekstremisht të ulët në Gjeorgji e përjashtuam nga llogaritja e mesatares, sepse origjinon nga vitet 1990 dhe nuk

INFOGRAFIKA:

Paga minimale neto ligjore si përqindje e pagës së jetesës ndërkufitare bazë e vlerësuar në Evropë në monedhat vendase, 2018. (Shifra e parë është paga e jetesës bazë ndërkufitare; shifra e dytë është paga minimale neto ligjore)




PAGAT MINIMALE LIGJORE KUNDREJT PRAGUT TË VARFËRISË TË BE-SË

Tabela tregon se pagat minimale neto ligjore janë nën kufijtë statistikorë të varfërisë siç përcaktohet në BE. Mesatarisht, paga minimale ligjore përfaqëson vetëm 2/3 e kufirit të varfërisë. Pagat minimale ligjore nuk janë immune ndaj varfërisë. Punëtorët që fitojnë paga minimale ligjore (si shumica e punëtorëve të prodhimit të veshjeve) janë ekstremisht të varfër, madje edhe sipas pragut të varfërisë të vetë BE-së.

INFOGRAFIKA:

Paga minimale neto ligjore në proporcion me kufirin e varfërisë në BE , 2018



BE-SILC pragu i rrezikut të varfërisë, 2018

60% e pagës mesatare kombëtare neto, 2018

PSE PRAGU I VARFËRISË PREJ 60% TË PAGËS MESATARE ËSHTË JOADEKUAT PËR TË MATUR VARFËRINË NË PUNË NË EVROPË - LINDJE/JUG?

Në tabelën më lart, krahasuam pagën minimale ligjore me kufirin e varfërisë. Megjithatë, tabloja e qartë është edhe më e nderë, sepse ky kufi varfërie – edhe pse pranohet gjerësisht si kufiri i varfërisë në BE dhe përtej – nuk arrin të japë një matje të përshtatshme varfërie në vendet që analizon ky punim.

Studimi ynë për pagën e jetesës në rajon tregon se pragu 60% nuk është aspak i mjaftueshëm për të përballuar jetesën në Evropën juglindore. Arsyeja kryesore është niveli i përgjithshëm i ulët i shumicës së pagave dhe rrjedhimisht i bie të jetë e ulët edhe paga mesatare. Ky prag nuk është kuptimplotë në vendet që e kanë të lartë si varfërinë në punë, ashtu edhe normat e varfërisë në përgjithësi, ku pagat mesatare janë po ashtu shumë të ulëta dhe nuk sigurojnë standard të denjë jetese; nuk pasqyrojnë koston aktuale të jetesës. Të ardhurat mesatare si matës për varfërinë mund të aplikohen vetëm në vendet me njëfarë mirëqenieje dhe niveli marrëdhëniesh industriale, ku pagat mesatare mjaftojnë për të bërë një jetë të denjë. Po kështu, për vendet më punësim të lartë informal si Gjeorgjia, Rumania apo Bullgaria, të ardhurat statistikore mesatare janë vetëm pjesërisht përfaqësuese.

Gjetjet tona empirike u konfirmuan nga studiuesit Fabo dhe Guzi të Institutit të Bashkimit Tregtar Evropian; ²⁷ sipas Fabo-s dhe Guzi-t, në Bullgari, Kroaci, Rumani dhe Spanjë, familjet me të ardhura të ulëta mezi përballojnë jetesën, por të ardhurat e tyre nuk konsiderohen të ulëta prej pragut të rrezikut të varfërisë të BE-SILC:

“në një sërë vendesh më të varfra të BE-së, të ardhurat mbi pragu e varfërisë mund të mos mjaftojnë për të mbuluar kostot minimale të shportës bazë të mallrave dhe shërbimeve. Kështu, treguesit e varfërisë për të ardhurat relative të publikuara nga Eurostat në shumë vende nuk arrijnë të masin në mënyrë të besueshme përmasat e varfërisë”.²⁸

Ata theksojnë nevojën për ta përshkallëzuar edhe më lart analizën, nga individët te familjet, “me qëllim që të pasqyrohet më mirë fakti se kujdesi për pjesëtarë familjesh ekonomikisht inaktivë është realitet për shumë evropianë.”²⁹

Për të përfunduar, na duhet të deklarojmë se pragu i varfërisë i BE-së nuk arrin ta pasqyrojë si duhet varfërinë. **Kjo do të thotë se, në realitet, varfëria e punëtorëve të prodhimit të veshjeve është edhe më akute sesa e tregojnë statistikat e varfërisë të BE-së.**

Jo vetëm nivelet me të cilat përcaktohen pagat minimale janë joadekuate, por të pamjaftueshme janë edhe matjet statistikore të varfërisë që përdoren për të pasqyruar nivelet e varfërisë.

27. Fabo, B. dhe Guzi, M. (2019) Kostoja e jetesës në BE: sa para duhen?, Dokument Politikash ETUI, nr. 4.

28. Po aty.

29. Po aty.

6 Pse nevojitet një pagë ndërkufitare bazë?

Industria e prodhimit të veshjeve përfaqëson shembullin tipik të zinxhirit të vlerës që nxitet nga blerësit.

Kompanitë kryesore, siç janë markat e njohura dhe shitësit e pakicës, kontrollojnë se si vlera shpërndahet në zinxhirin e prodhimit, si dhe ku dhe kur duhet të ndodhë fabrikimi. Prandaj, këto firma i quajmë **punëdhënës kryesorë**.

Këto shoqëri, shumica e të cilave e kanë selinë në Amerikën e Veriut dhe në shtetet anëtare perëndimore të BE-së, e zhvendosin prodhimin ndërmjet fabrikave brendapërbrenda një vendi dhe nga një vend në tjetrin. Zhvendosja e biznesit bëhet më e thjeshtë kur ka më pak vlerë të shtuar – pra, duke u vendosur në vende me paga të ulëta. Për shkak të skemës (prej shumë kohësh) të tregtisë me përpunim pasiv në Evropë, pjesa më e madhe e vlerës së shtuar në vendet prodhuese të Evropës Juglindore janë pagat që u paguhen punëtorëve në operacionet prerje+qepje+aksesorë – që në terma absolutë është një vlerë shumë e vogël.

Kjo skemë prodhimi dhe tregtie, edhe pse në Evropë ka ekzistuar që nga vitet '70, ka qenë dominuese në mënyrën e të bërit biznes në industrinë e veshjeve në Evropën Juglindore që nga vitet 1989-1990; kërkon shumë pak vlerë të shtuar.³¹

Për të përballuar konkurrencën e jashtme, furnitorët filluan të ulin pagat dhe kostot e pagave. Kjo strategji u pasua me një garë për pagat më të ulëta. Furnitorët në Evropën Juglindore filluan të konkurrojnë mes tyre dhe me furnitorët e vendeve prodhuese aziatike. Heqja e kuotave globale për tekstilin në vitin 2005 bëri që furnitorët të tërhiqen si me magnet nga hapja e tregut nga një prej prodhuesve më të mëdhenj në botë: Kina. E gjitha kjo krijoi presion shtesë te furnitorët që nisën një trajektore konkurrueshmërie drejt shkurtimit të pagave dhe kostove të tjera jo-paga.

Koncepti që synon të vendosë punëtorin në qendër duhet të marrë parasysh këtë model global të modës së prodhimit në masë. Ai synon të sfidojë kërcënimin konstant të zhvendosjes së biznesit dhe të shmangë konkurrencën e bazuar te pagat. Ky model biznesi krijon nevojën për një politikë që lufton konkurrencën e zhvendosjes së biznesit ndërmjet vendeve fokusuar te pagat – e prapëseprapë nuk i bënë vendet e ndryshme të barabarta.

30. Fernandez-Stark, Frederik dhe Gereffi (2011).

31. Leitner dhe Stehrer (2014), fq. 18 e vijuese.

32. Podkaminer (2013), p. 35

33. Pickles dhe Smith (2011).

CILI ËSHTË DALLIMI KRYESOR NË VLERËSIMET E PAGËS EKZISTUESE TË JETESËS?

Ekzistojnë plot vlerësime të pagës së jetesës prej OJF-ve dhe institucioneve të ndryshme, si vetë CCC, Koalicioni Global për Pagën e Jetesës apo Fondacioni i Treguesve të Pagës me seli në Holandë. Këto vlerësime të pagës së jetesës fokusohen në vende individuale dhe madje edhe në rajone brenda vendeve. Synimi është ndryshe: **paga jonë e jetesës përcaktohet me logjikën e zinxhirëve të furnizimit globalë mes kufijve.**

Paga e jetesës kombëtare dhe ndërkuftare plotësojnë njëra tjetrën. Një nismë e spikatur për vlerësimin e pagës së jetesës kombëtare u krijua në Çeki. Një grup jozyrtar që përfshinte organizatat CCC dhe përfaqësues të sindikatave përcaktuan “pagën minimale të denjë”. Por, nëse vlerësimet e pagës së jetesës kombëtare nuk shkojnë paralel me qasjet ndërkuftare, ato rrezikojnë të shtojnë konkurrencën e pagave. Politikat e veçuara dhe me bazë kombëtare për trajtimin e këtij problemi mbartin rrezikun e rënies në grackën e “avantazhit konkurrues” dhe kështu nuk arrijnë të ndalin spiralen pikatë që synojnë të sfidojnë. Ato duhen plotësuar me politika ndërkuftare.

Një mangësi e ngjashme vihet re në qasjen e ACT-së (Veprim, Bashkëpunim, Transformim). ACT është një marrëveshje vullnetare ndërmjet markave globale dhe Unionit Global Industrial për të zbatuar procese kontratash kolektive kombëtare në nivel industrie në sektorët e prodhimit të veshjeve, tekstilit dhe këpucëve. Qëllimi i saj është që të bëjë bashkë sindikatat dhe furnitorët që të negociojnë mbi pagat në nivel kombëtar – me njëfarë përfshirjeje të markave që ta përfshijnë këtë shifër të negociuar si kosto në praktikën e blerjes. Programi synon të rrisë pagat në shkallë kategorie profesionale dhe sektorësh. Shqetësimi ynë është se kjo nuk i detyron markat që të rrisin ndjeshëm çmimin që u paguajnë furnitorëve në një mënyrë ligjërishit detyruese dhe të ekzekutueshme. Pra, kjo qasje nuk arrin të adresojë problemin që rritjet e pagave duhet të jenë edhe rajonale për të shmangur zhvendosjen e biznesit të prodhimit. Për më tepër, programi nuk ka miratuar një përkufizim për standardin e pagës së jetesës. Pagat me këtë lloj negocimi mund të rriten, por, sipas parashikimit tonë nisur nga modeli ekonomik global, nuk do të ngushtojnë mjaftueshëm hendekun mes pagës minimale dhe pagës së jetesës në ndonjë të ardhme të afërt.³⁵



34. <https://www.dustojnamzda.cz>

35. Fushata e Rrobave të Pastra, Pagat e Qepura 2019: Gjendja e pagave në industrinë globale tekstile.

<https://archive.cleanclothes.org/resources/publications/tailored-wages-2019-the-state-of-pay-in-the-global-garment-industry/view>, p. 19.

7 Metodologjia e llogaritjes së pagës së jetesës bazë ndërkufitare me në qendër punëtorin

ÇFARË DUHET TË OFROJË?

Ne kemi nevojë për një metodë të thjeshtë dhe solide për llogaritjen e pagës së jetesës bazë ndërkufitare, si edhe që shmang mekanizmat e shtrenjtë dhe kompleksë të përlllogaritjeve dhe përditësimit. Metoda duhet të jetë e aksesueshme dhe e kuptueshme për punëtorët dhe organizatat e tyre. Vlerësimi i pagës së jetesës duhet të jetë pragmatik dhe i lehtë për t'u përdorur nga palë të ndryshme interesi (grupet për të drejtat e punës, sindikatat, markat, qeveritë, furnitorët). Në gjykimin tonë, këto janë tipare të rëndësishme të pagës së jetesës e me në qendër punëtorin.

I vetmi vlerësim i pagës së jetesës deri tani që ka në qendër punëtorin dhe është ndërkufitar është ai i **Pagës Minimale Aziatike (AFW)**, që u miratua nga Aleanca e Pagës Minimale Aziatike në vitin 2009 dhe tashmë njihet gjerësisht.

PSE ËSHTË E THJESHTË?

Metoda e llogaritjes së AFW-së përdor ligjin e Engelit për të vlerësuar koston e jetesës. Analiza me këtë ligj (korrelacioni mes shpenzimeve familjare për ushqime dhe mirëqenies së një komuniteti) mundëson fokusin te shpenzimet për ushqime, si tregues kyç; kjo analizohet veçmas nga kategoritë e shpenzimeve të tjera.

Kjo metodë ka avantazhin e madh se e bën llogaritjen shumë më të lehtë. Thjesht duhet të anketojmë shpenzimet për artikujt ushqimorë – pra, jo të gjitha shpenzimet shtëpiake – dhe ta shumëzojmë me koston e artikujve ushqimorë, si përqindje e shpenzimeve familjare në mënyrë që të përftohet një vlerë e koston së jetesës.

CILAT PARIME TË LLOGARITJES HUAZUAM NGA AFW-JA?

Metoda e llogaritjes së AFW-së i ndan shpenzimet familjare në dy kategori: ushqimore dhe joushqimore. AFW-ja e shpreh komponentin ushqimor me kalori dhe jo me artikuj ushqimorë. Qëllimi është të sigurojë një bazë të përbashkët mes shteteve dhe kulturave ushqimore. Shifra kalorike bazohet në studimin e kalorive që merren në nivelin e kufirit të varfërisë të përcaktuar nga organet qeveritare dhe ndërqeveritare të shteteve aziatike. Aleanca AFW ka marrë për bazë shifrën relativisht të lartë të qeverisë indoneziane prej 3 000 kalorish në ditë, me argumentin se paga minimale nuk duhet të rezultojë në uljen e standardeve të asnjë shteti dhe nuk duhet të nxisë zhvlerësimin e punës së grave në industrinë e prodhimit të veshjeve. Kështu, miratoi standardin prej 3 000 kalorish në ditë.

36. Aleanca Aziatike për Pagën Minimale, <https://asia.floorwage.org/>

37. Bhattacharjee, A. dhe Roy, A. (2012) 'Asia Floor Wage dhe kontratat kolektive industriale globale', International Journal of Labour Research, Vol. 4, nr. 1, fq. 77.

Në zhvillimin e një qasjeje normative, ku kostoja ushqimore analizohet si pjesë e shpenzimeve familjare të klasës punëtore për të llogaritur pagën bazë të jetesës, Aleanca AFW vendosi në vitin 2009 që të prezantojë **raportin 1:1 të kostos ushqimore ndaj shpenzimeve joushqimore** në mënyrë universale për shtetet e prodhimit tekstil në Azi. Në vitin 2020, Aleanca AFW e rishikoi këtë raport në **1:1.25 të kostos ushqimore ndaj shpenzimeve joushqimore**. Brenda 55% që përfshin kostot joushqimore, 10% janë të ardhura diskrecionale, p.sh. kursime për raste urgjente.

Duke ndjekur qasjen me ndjeshmëri gjinore, siç u tha më lart, Paga Minimale Aziatike u llogarit bazuar në një familje me **tri njësi konsumatore**.



Në përfundim, monedha me të cilën shprehet Paga Minimale Aziatike është **Pariteti i Fuqisë Blerëse të Bankës Botërore (PPP USD)**. Kjo monedhë virtuale u zgjodh për të pasur një shifër universale që konvertohet në çdo monedhë kombëtare; kjo shmang luhatjet e tregut dhe politikave të këmbimit të valutës, si dhe merr parasysh fuqinë blerëse të monedhave. PPP matet duke gjetur vlerën në monedhën vendase të të njëjtave mallra që blihen me 1 USD në SHBA; kjo shpreh fuqinë blerëse të monedhës vendase në raport me dollarin amerikan (USD). Nëse kjo shportë kushton 1 USD në SHBA dhe 0.5 USD në Serbi, atëherë kursi i këmbimit të paritetit të fuqisë blerëse është 2:1.³⁸

Duke qenë se pagat e jetesës llogariten në nivel shteti dhe konvertohen në PPP USD, Aleanca AFW sheh shifrat PPP USD në mbarë rajonin dhe merr një vendim politik bazuar në shifrën rajonale. **Kjo shifër rajonale është Paga Minimale Aziatike**, që pastaj konvertohet sërish në monedhën vendase. Kjo është shifër neto, d.m.th. pasi zbriten sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe taksat. Përfitimet në natyrë apo të tjera nuk janë marrë për bazë. Pra, nëse një punëdhënës ofron fjetjen apo drekë në mensë, shifra e Pagës Minimale Aziatike nuk ulet. Punëtorët duhet të kenë mundësinë t'i përftojnë këto nevoja bazë nga paga e tyre. AFW-ja përcakton pagën bazë të jetesës me të cilën punëtori të mund të mbajë veten dhe personat nën varësi.

KU DEVIJUEM NGA METODOLOGJIA E AFW-SË PËR LLOGARITJEN E PAGËS MINIMALE NË EVROPË?

Për llogaritjen e Pagës Minimale në Evropë – pra, pagën e jetesës bazë ndërkufitare në Evropë – u nisëm nga supozime të njëjta me ato të metodologjisë AFW. Me gjithë të përbashkëtat mes vendeve prodhuese në Azinë jugore, juglindore dhe lindore, si dhe Evropën qendrore, lindore, dhe juglindore, prapë ekzistojnë faktorë kontekstualë dhe strukturorë që diktojnë përshtatjen e formulës.

E pranuar qasjen për ta bazuar llogaritjen në 3 000 kalori në ditë dhe në shpenzimet ushqimore si treguesi kryesor i mirëqenies, por në një pikë na duhej të përshtatnim kostot ushqimore si përqindje e pagës së jetesës, kostove ushqimore të punëtorëve dhe numrit të njësive konsumatore në familje, sipas kontekstit evropian. Vendimet përkatëse u morën pas konsultimeve në takime të ndryshme të grupit gjatë periudhës 6-vjeçare.

38. Sidoqoftë, ky tregues ka disa elementë të dobët. Shporta e mallrave e përcaktuar sipas PPP-së ka tendencë drejt rutinave të konsumit në vendet e zhvilluara dhe klasës së mesme, kështu që ndryshon nga shporta e mallrave dhe shërbimeve të AFW-së e cila bazohet te mesataret aktuale të shpenzimeve ushqimore dhe joushqimore të klasës punëtore. Llogaritja bëhet në intervale më të gjata dhe nuk është statike.

HAPI 1: NUMRI I NJËSIVE KONSUMATORE

Në vendet prodhuese evropiane, madhësia e familjeve sipas statistikave kombëtare priret të jetë më e vogël sesa në vendet prodhuese aziatike. Megjithatë, në llogaritjen e pagës së jetesës, në raportin mes përfituesit të pagës dhe personave që varen prej tij duhet të merret parasysh edhe familjet në kushte më të vështira, siç janë familjet me një prind, apo të papunët afatgjatë. Për të pasqyruar papunësinë e papritur, presionin e lartë të emigrimit, pasigurinë dhe informalitetin, është e nevojshme të përdoret një supozim realist për punëtorët ekuivalentë me kohë të plotë në familje, që do të thotë një përfutjes page për familje.

Siç u tha më lart, qasja me ndjeshmëri gjinore duhet të faktorizohet kur përcaktojmë numrin e njësive konsumatore për të cilat llogaritet paga e jetesës. Metoda e përcaktimit të pagës së jetesës që fokusohet te kapaciteti i plotë i punëtorëve gra mund të krijojë gjithashtu hapësirë për debat më të gjerë shoqëror në lidhje me shpërndarjen e punës dhe të kohës mes burrave dhe grave. Për më tepër, në disa shtete gjetëm evidenca se vajzave u jepej ushqim më i keq sesa djemve të familjes. Në këtë kontekst, duke ndjekur edhe qasjen e Pagës Minimale Aziatike, u propozua një numër më i lartë njësish konsumatore

sesa madhësia statistikore mesatare e familjes që ishte me 3 njësi konsumatore. Familjet e klasës punëtore priren të jenë më të gjera dhe më të mëdha sesa familjet mesatare dhe të ardhurat e tyre priren të jenë më të ulëta sesa ato të familjeve mesatare.³⁹

Këtë e shohim në kontekstin e gjerë të krizave sociale të vazhdueshme. Në fillim të viteve '90, rajoni post-socialist përjetoi "kthesën më akute të varfërisë dhe mirëqenies në botë (PNUD 1999). Në raportin për Konferencën Ndërkombëtare të Punës (ILC), ILO dëshmon për një shpërbërje sociale drastike dhe shpërthim varfërie në këtë rajon. Rrjedhimisht, rajoni është tronditur nga nivele drastike të emigracionit që nga vitet 1990-1991. Në 30 vitet e fundit, ka regjistruar një prej humbjeve më të mëdha dhe të vazhdueshme të popullsisë.

Që nga fillimi i viteve 1990, rreth 20 milion njerëz (5.5% e popullsisë së Evropës Jug/Lindje) vlerësohet se janë larguar nga ky rajon. Nga fundi i vitit 2012, Evropa Juglindore përjetoi një prej bjerrjeve më të mëdha të popullsisë me rreth 16% të popullsisë që kishte në fillimin e viteve 1990. Nisur nga kushtet e pasigurisë, informalitetit dhe familjarëve që emigronin, familjet e zgjeruara u bënë rrjete mbështetjeje. Prandaj, ne zgjodhëm variantin me tri njësi konsumatore për familje, pikërisht si AFW-ja.



39. Shih: Fabo, B. dhe Guzi, M. (2019) Kostoja e jetesës në BE: Sa para duhen?, Dokument Politikash ETUI, nr. 4.

40. Atoyan, R. et al. (2016) 'Emigrimi dhe ndikimi i tij ekonomik në Evropën Lindore', FMN, Punim Diskutimi Stafi.

HAPI 2: KOSTOT USHQIMORE TË PUNËTORËVE


Pas përcaktimit të numrit të njësive konsumatore, hapi tjetër ishte që të shihej se sa do të shpenzonin punëtorët për një dietë model prej 3 000 kalorish në ditë. Për këtë, bëmë **vrojtime të shportës ushqimore të punëtorëve** në disa vende. Sërish, iu kthyer metodologjisë së AFWA-së për të llogaritur shpenzimet ushqimore sipas vlerësimeve të vetë punëtorëve, jo mbi bazën e statistikave kombëtare. Ndonëse institutet kombëtare të statistikave i ofrojnë këto të dhëna, qëllimi i vërtetimit të shportës ushqimore të CCC-së është pasqyrimi sa më i përafërt i realiteteve të familjeve të klasës punëtore. Ashtu sikurse edhe vetë filozofia e CCC-së dhe e AFWA-së, edhe Fabo dhe Guzi theksojnë se edhe vetë familjet i dinë shpenzimet e veta të jetesës dhe njohuritë e tyre mund të jenë të dobishme në përcaktimin e niveleve të përshtatshme të të ardhurave minimale.⁴¹

Që nga viti 2016 deri më 2019-ën, janë kryer disa vërtetime të shportës ushqimore në pesë vende: Shqipëri, Maqedoni të Veriut, Ukrainë, Hungari dhe Moldavi. Për secilin prej këtyre vendeve, u përpilua një dietë me 3 000 kalori në ditë, që pasqyron rutinat/ modelet e ushqyerjes së vendit dhe rajonit. Më pas, një kampioni prej 20 punëtorësh të industrisë së veshjeve nga zonat rurale edhe urbane, iu kërkua t'i vinin çmimin artikujve të renditura ushqimore. Me sondazhet e kryera, dolëm me një kosto për 3 000 kalori në ditë për tri njësi konsumatore. Më pas, kostot e ushqimit u konvertuan në PPP USD (norma e këmbimit e vitit 2017 për konsumin privat).

Në fund, llogaritëm një mesatare prej 792 PPP USD për koston e ushqimit. Në llogaritjen e kësaj mesatareje, përfshimë kostot ushqimore për Rumaninë jo të gjeneruara nga një vërtetim i shportës ushqimore të punëtorëve, por sipas çmimeve të ofruara nga statistikat kombëtare. Pavarësisht kësaj metodologjie të ndryshme, po e përdorim këtë vlerësim, pasi është e vetmja llogaritje e kostove ushqimore në vendin më të madh prodhues në rajon.

INFOGRAFIKA:

Kostoja ushqimore familjare në monedhën vendase 2016-2019



41. Shih: Fabo, B. dhe Guzi, M. (2019) Kostoja e jetesës në BE: sa para duhen?, Dokument Politikash ETUI, nr. 4.

42. Guga (Syndex), Mihailescu (ICCV), Spataru (Syndex): Coșul minim de consum lunar pentru un trai decent pentru populația României, fq. 43: <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/bukarest/14759.pdf>. Publikimi i llogaritjes së pagës së jetesës bëhet nga një koalicion për pagë të denjë, që lobon për indeksimin e pagave minimale ligjore sipas koston reale të jetesës siç llogaritet këtu

HAPI 3: KOSTOT E USHQIMIT SI PJESË E SHPENZIMEVE TË FAMILJES

Në shumë intervista në terren, punëtorët u shprehën se vërtet i shpenzojnë një pjesë të madhe të të ardhurave për të blerë ushqime. Kjo sasi shkon nga 40% në Çeki, në 80% në Shqipëri, madje shkon edhe më lart në Bosnje-Hercegovinë.

AFW-ja llogarit 45% shpenzime për ushqime dhe 55% për kosto joushqime, duke përfshirë të ardhurat diskrecionale. Iu referuam disa burimeve që përqindja e koston ushqimore e vendeve objekt vrojtimi të ishte sa më afër realitetit. Në fakt, pjesa ushqimore ndryshon shumë mes 15 vendeve të

grupit. Pas rakordimit të të dhënave empirike dhe diskutimeve në grup, vendosëm për dy grupe përfaqësuese për përqindjen e koston ushqimore: 30% dhe 40%.

HAPI I FUNDIT: LLOGARITJA E STANDARDIT TË PAGËS SË JETESËS

Kjo rezultoi në dy vlera të pagës bazë të jetesës për dy grupet në PPP USD. Pastaj, konvertuam vlerat në monedhat vendase. Pagat e ekstrapoluara u rakorduan me pagën e jetesës që na dhanë punëtorët në intervistat tona; prapë i kontrolluam për të qenë realiste gjatë takimeve me Fokus Grupin Evropian për Prodhimin.

TABELA:

Shpenzimet mesatare familjare për ushqimet që kanë 3,000 kalori në ditë bazuar në vrojtimitet e shportës ushqimore të punëtorëve, grupet e vendeve për ushqimin si përqindje e shpenzimeve familjare, llogaritja e pagës së jetesës bazë ndërkufitare në Evropë, 2018⁴³

Vendet sipas përqindjes që zë ushqimi	Kostot ushqimore të përgjithësuara në PPP USD (3 njësi konsumatore)	Grupet e përqindjes së ushqimeve	Paga Minimale Evropiane (PME) në PPP USD	PME në monedhën vendase
Republika Çeke	792	30%	2,640	37,382
Hungaria	792	30%	2,640	409,754
Sllovakia	792	30%	2,640	1,452
Polonia	792	30%	2,640	5,042
Bullgaria	792	30%	2,640	2,033
Turqia	792	30%	2,640	5,095
Kroacia	792	30%	2,640	10,428
Rumania	792	30%	2,640	5,069
Serbia	792	40%	1,980	98,030
Bosnje-Hercegovina	792	40%	1,980	1,604
Gjeorgjia	792	40%	1,980	1,762
Maqedonia e Veriut	792	40%	1,980	45,540
Shqipëria	792	40%	1,980	104,980
Ukraina	792	40%	1,980	14,197
Moldavia	792	40%	1,980	14,236

Burimi: llogaritjet tona

Rekomandime

Sipas **Parimeve Udhëheqëse të OKB-së për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut**, shtetet prodhuese dhe pritëse të industrisë tekstile dhe markat/shitësit me pakicë të këpucëve, Bashkimi Evropian dhe vetë markat dhe shitësit me pakicë kanë detyrimin dhe përgjegjësinë të respektojnë dhe të mbrojnë të drejtat e njeriut kurdo që prodhojnë. Kjo do të thotë se duhet të veprojnë me kujdesin e duhur për të garantuar që punëtorët të marrin një pagë jetese dhe ata vetë të marrin masa korrigjuese kur kjo nuk ndodh.

- **Shtetet prodhuese të këtyre markave/ shitësve me pakicë dhe BE-ja** kanë detyrimin që markat dhe shitësit me pakicë të respektojnë të drejtat e njeriut dhe të punës në mbarë botën.
- **Shtetet prodhuese të furnitorëve për këto marka/ shitësit me pakicë dhe BE-ja** kanë detyrimin të mbrojnë të drejtat e njeriut dhe të punës të punëtorëve të tyre dhe të zbatojnë pagën minimale që lufton varfërinë dhe jo të krijojnë një krah pune të varfër dhe të përjashtuar nga ana sociale.
- **Markat/shitësit me pakicë** kanë përgjegjësinë të paguajnë çmimin e plotë të produktit që porositin – çmim në përputhje me të drejtat e njeriut. Kjo përfshin një pagë me të cilën punëtori dhe familja e tij të mund të jetojnë.
- **Markat/shitësit me pakicë** kanë përgjegjësinë të mos përfitojnë nga fuqia blerëse e tyre apo zbatimi i dobët i të drejtave të punës dhe të njeriut nga Shteti, si dhe të respektojnë të drejtat ndërkombëtare të njeriut dhe punës, duke përfshirë edhe të drejtën për pagë jetese përtej thjesht respektimit të ligjeve dhe akteve normative të brendshme që mbrojnë të drejtat e njeriut.

Konkretisht:

1. Markat dhe kompanitë e veshjeve duhet të përcaktojnë hapa publikë, konkretë dhe të matshëm në të gjithë zinxhirin e tyre të furnizimit, që punëtorët e industrisë së veshjeve të marrin një pagë jetese brenda një kuadri kohor të arsyeshëm, sipas qasjes në Udhërrëfyesin drejt një Page Jetese. Këto hapa duhet të synojnë arritjen e standardit të propozuar për vitin 2018: për **Sllovakinë, Hungarinë, Poloninë, Turqinë, Kroacinë, Çekinë, Bullgarinë dhe Rumaninë**, që është 2 640 PPP USD dhe për **Serbinë, Bosnje-Hercegovinën, Gjeorgjinë, Maqedoninë e Veriut, Shqipërinë, Ukrainën dhe Moldavinë** që është në masën 1 980 PPP USD.
2. Markat dhe kompanitë e veshjeve duhet të negociojnë dhe të nënshkruajnë marrëveshje të detyrueshme ligjore me përfaqësuesit e punëtorëve që kërkojnë pagesën e çmimeve shumë më të larta për furnitorët, duke u dhënë atyre kapacitetin financiar për të paguar një pagë jetese që mbulon nevojat bazë të punëtorit dhe familjes së tij. Markat dhe shitësit e modës me pakicë **duhet të garantojnë që llogaritjet e tyre të çmimeve të përfshijnë pagesën e hendekut mes Pagës Minimale në Evropë dhe Pagës Minimale Ligjore në të gjitha vendet prodhuese të veshjeve në Evropë.**

